



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTËR I SHTETIT PËR RININË DHE FËMIJËT

METODOLOGJIA DHE PLANI I VEPRIMIT NË KUADËR TË PROGRAMIT KOMBËTAR TË PRAKTIKAVE TË PUNËS, THIRRJA E TETË

Në zbatim të vendimit nr. 395, datë 29.04.2015 të Këshillit të Ministrave “Për Miratimin e Programit Kombëtar të Praktikave të Punës në Administratën Shtetërore dhe Institucionet e tjera Publike”, i ndryshuar, Programi Kombëtar i Praktikave të Punës do të realizohet sipas planit të veprimit dhe metodologjisë së miratuar nga Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, **që përcakton shpalljen për thirrjen e radhës, afatin për aplikim, dokumentet për aplikim dhe mënyrën e vlerësimit.**

1. Puna përgatitore për planifikimin e nevojave

- Institucionet e përfshira në këtë program i komunikojnë Ministrin të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, personat e kontaktit për programin, numrin e praktikantëve dhe profilet e tyre studimore.
- Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët është përgjegjës për mbledhjen e të dhënave dhe plotësimin e databazës për të gjitha institucionet e përfshira në program.
- Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët përgatit materialet për publikim në platformën online: <https://praktika.riniafemijet.gov.al>
- Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët mban komunikimin me personat e kontaktit të të gjithë institucioneve të përfshira në program.
- Ministritë, institucionet e tjera publike, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe shoqëritë tregtare, nëpërmjet personave të kontaktit të konfirmuar, organizojnë dhe udhëzojnë institucionet dhe njësitë në varësi, në lidhje me tërësinë e procesit të zhvillimit të programit.

2. Përgatitja dhe shpallja e procesit të aplikimit

- Aktivizimi i platformës online për aplikim: <https://praktika.riniafemijet.gov.al>
- Shpallja e thirrjes realizohet nga Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, me pjesëmarrjen e institucioneve të tjera bashkëpunuese.
- Shpallja e thirrjes i dërgohet institucioneve, të cilat kanë për detyrim ta publikojnë në faqet e tyre zyrtare dhe mediat sociale.
- Procesi i aplikimit fillon në datë **1 Qershor 2023** dhe përfundon në **30 Qershor 2023**.
- Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët ka të drejtë të zgjasë afatin e aplikimit.

3. Kriteret e Aplikimit

- Aplikantët duhet të kenë mbushur 21 vjeç deri në datë **1 Shtator 2023**, si dhe të jenë deri në 26 vjeç në datë **1 Shtator 2023** (fillimi i programit të praktikës).
- Aplikantët duhet të jenë minimalisht të diplomuar në programet e studimit të ciklit të parë “Bachelor”, deri në datë **1 Shtator 2023**.
- Aplikantët *nuk* duhet të kenë qenë pjesë e programit në thirrjet e mëparshme, pasi qëllimi i tij është ofrimi i një përvoja kualifikuese, që ndikon në zhvillimin e aftësive profesionale e të shprehive të tyre praktike, në njohje me sistemin administrativ publik, shoqëritë tregtare dhe organizatat jofitimprurëse.

4. Kohëzgjatja e Programit

- Programi Kombëtar i Praktikës së Punës, thirrja e tetë, do të zgjasë 3 (tre) muaj.

- b) Programi fillon në datë **1 Shtator 2023** dhe përfundon në datë **1 Dhjetor 2023**.

5. Procesi i aplikimit

- a) Aplikimi kryhet në platformën zyrtare të programit: <https://praktika.riniafemijet.gov.al>
b) Në platformën e aplikimit publikohen profilet studimore të kërkuara nga institucionet pjesëmarrëse në program, me qëllim orientimin e kandidatëve.

6. Formati i aplikimit

Në formatin e aplikimit kërkohen të dhënat si më poshtë:

- a) të dhënat personale;
b) studimet e fundit të përfunduara;
c) përcaktimi i mesatares së studimeve të fundit të përfunduara, me të cilat aplikanti po kandidon;
d) jetëshkrimi;
e) letra e motivimit, në të cilën kërkohet të shpjegohet se si kjo praktikë në institucionin përkatës do të ndikonte në rritjen e tij/saj profesionale.

7. Fushata e komunikimit për thirrjen e tetë

- a) Institucionet pjesëmarrëse në program bashkëpunojnë për publikimin e thirrjes së tetë të programit.
b) Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët organizon takime informuese me studentë, të rinj, organizatat rinore dhe/ose organizatat për të rinjtë, shoqëritë tregtare, etj.

8. Ngritja e komisioneve përzgjedhëse

- a) Institucionet pjesëmarrëse ngrenë komisionet përzgjedhëse përpara mbarimit të afatit të aplikimit.
b) Institucionet përcaktojnë nëse njësitë nën varësi ngrenë komisione përzgjedhëse apo përzgjedhja realizohet nga vetë institucioni, nga i cili kanë varësi; mbështetur në kërkesat e profileve studimore të deklaruara.
c) Komisioni është i përbërë nga minimalisht 3 (tre) persona.
d) Personi kontaktit i institucionit është anëtar.
e) Nëpërmjet personave kontakt të konfirmuar, organizojnë dhe udhëzojnë institucionet dhe njësitë nën varësi në lidhje me tërësinë e procesit të ngritjes së komisioneve.

9. Komunikimi i aplikimeve

- a) Personi i kontaktit i Ministrisë së Shtetit për Rininë dhe Fëmijët i dërgon në format elektronik aplikimet e marra në platformë për institucionin personave të kontaktit të programit, brenda 3 (tre) ditëve kalendarike nga mbyllja e aplikimeve.
b) Ministrinë, institucionet e tjera publike, njësitë e vetëqeverisjes vendore, shoqëritë tregtare dhe organizatat jofitimprurëse dërgojnë elektronikisht aplikimet në personat e kontaktit të institucioneve dhe njërive që kanë vartësi dhe në të cilat janë ngritur komisione përzgjedhëse.

10. Përzgjedhja e kandidatëve fitues

Vlerësimi: Vlerësimi maksimal është 40 pikë dhe kryhet si më poshtë:

- I. vlerësimi për nivelin e diplomës:

- a) Bachelor 5 pikë
- b) Master profesional 10 pikë
- c) Master shkencor 15 pikë

II. vlerësimi për mesataren e notave:

- a) 5-6 5 pikë
- b) 7-8 10 pikë
- c) 9-10 15 pikë

III. Letra e motivimit vlerësohet nga 1 deri në 10 pikë.

Përzgjedhja:

- a) Përzgjedhja e kandidatëve mbështetet në profilet studimore të kërkuara nga institucioni, të cilat shpallen në platformën e aplikimit për thirrjen e tetë.
- b) Komisioni harton listën me kandidatët sipas renditjes së pikëve, ndarë sipas profileve studimore.
- c) Komisioni shpall listën fituese sipas profileve studimore brenda 3 (tre) ditëve pune nga dërgimi i aplikimeve.
- d) Komisioni harton listën e kandidatëve në pritje.

11. Lajmërimi i fituesve

- a) Institucioni pjesëmarrës në program është përgjegjës për lajmërimin dhe verifikimin e fituesve brenda 2 (dy) ditëve pune nga shpallja e fituesve.
- b) Fituesit lajmërohen mbi datën e paraqitjes në institucion dhe dokumentacionin që duhet të dorëzohet në institucionin ku kryhet programi.
- c) Institucionet e përfshira në program dërgojnë elektronikisht pranë Ministrisë së Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, emrat e praktikantëve që rezultojnë fitues të procesit të përzgjedhjes dhe verifikimit brenda 6 (gjashtë) ditëve pune nga data e dërgimit të aplikimeve, sipas formatit dhe të dhënave të përcaktuara nga Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët.
- d) Ankimimet bëhen brenda 3 (tre) ditëve kalendrike nga shpallja e fituesve.

12. Procesi i rishpërndarjes

- a) Në rast se institucioni nuk plotëson vendet e kërkuara me aplikimet e marra, mund të kërkojë kandidatë nga institucionet brenda të njëjtit sistem ministror, bashkiak apo të biznesit, si dhe mund të kërkojnë nga aplikimet e tjera, sipas sistemeve përkatëse, brenda 2 (dy) ditëve pune nga dërgimi i listës fituese.
- b) Koordinimin e rishpërndarjes e realizon personi kontaktit i Ministrisë së Shtetit për Rininë dhe Fëmijët brenda 3 (tre) ditëve pune nga dërgimi i kërkesës së institucioneve për vendet e paplotësuara.
- c) Institucionet përzgjedhin mes aplikantëve të dërguar nga personi kontaktit i Ministrisë së Shtetit për Rininë dhe Fëmijët sipas të njëjtës metodologji më sipër dhe shpallin fituesit brenda 2 (dy) ditëve nga dërgimi i aplikimeve shtesë.

13. Angazhimi i praktikantit në orë pune

- a) Praktikanti do të kryejë praktikën e punës pranë institucionit ku është pranuar, çdo ditë, nga e hëna deri të premten, orar zyrtar.
- b) Praktikanti, që të certifikohet për përfundim me sukses të programit, duhet të ketë marrë pjesë minimalisht në 80 % të periudhës së zhvillimit të programit.

14. Fillimi i programit

- a) Kandidati fitues dorëzon tek personi kontaktit në institucion jo më vonë se 10 ditë pasi ka filluar programin: jetëshkrim, fotokopje ID, kopje e noterizuar e listës së notave të studimeve të përfunduara, kopje e noterizuar e diplomës së studimeve të përfunduara.
- b) Personi kontaktit në çdo institucion konfirmon të dhënat e deklaruara në aplikim.
- c) Në qoftë se kandidati ka bërë deklaram të rremë nuk kualifikohet.
- d) Në rast skualifikimi apo të tërheqjes nga programi të një kandidati, personi kontaktit i programit përzgjedh të renditurin në radhë, me të njëjtin profil studimor, me pikët më të larta për atë institucion, sipas listës së pritjes së hartuar nga komisioni.
- e) Pas konfirmimit të të dhënave, nënshkruhet marrëveshja midis institucionit ku kryhet praktika dhe praktikantit, brenda 14 ditësh kalendarike nga fillimi i programit.
- f) Marrëveshja tip hartohet nga Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët.
- g) Personi kontaktit në çdo institucion koordinon procesin e përcaktimit të një mbikëqyrësi për secilin praktikant, i cili përmbush kriteret dhe detyrat e përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 395, datë 29.04.2015, i ndryshuar, pika 8 dhe 9.

15. Përfundimi i programit për Thirrjen e Tetë

- a) Hartohen nga grupi i punës dhe miratohen nga Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët formularët e vlerësimit për praktikantët nga mbikëqyrësit dhe formularët e vlerësimit të mbikëqyrësit nga praktikanti.
- b) Javën e fundit të zhvillimit të programit plotësohen formularët e vlerësimit nga mbikëqyrësi për praktikantët dhe nga praktikantët për mbikëqyrësit.
- c) Grupi i punës së Ministrisë të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët harton formatin e certifikatës për praktikantët që kanë zhvilluar me sukses programin.
- d) Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët verifikon me çdo institucion të përfshirë listën e praktikantëve që kanë kryer me sukses praktikën tre mujore.
- e) Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët përgatit certifikatën për çdo praktikant që ka përfunduar me sukses praktikën dhe i dërgon certifikatat tek institucionet përkatëse.
- f) Institucionet realizojnë shpërndarjen e certifikatave tek praktikantët.